

Schwartz: Tërnavava është

Agron Bajrami

Islami në Kosovë është i rrezikuar nga ekstremizmi, të cilit rrugën hapur ia mban kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavava. Kështu thotë Stephen Sylejman Schwartz, studiues i islamit, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Pluralizëm Islamik me seli në Washington të SHBA-së.

Schwartz, në një intervistë për "Kohën Ditore", të realizuar përmes postës elektronike, ka insistuar se largimi i Tërnavës është parakusht për adresimin e problemeve brenda Bashkësisë Islame të Kosovës, dhe jashtë saj, në luftimin e ndikimeve ekstreme në islamit shqiptar, që tradicionalisht ka qenë i moderuar dhe tolerant, dhe shembull për gjithë botën. Ai Tërnavën e quan diktator, derisa e akuzon edhe për plagjiaturë të magjistraturës.

Schwartz, një gazetar i njohur amerikan (më 1997 u bë mysliman hanefi), është autor i shumë librave, në mesin e të cilëve edhe disa për Kosovën dhe shqiptarët. Libri i tij "Islami tjetër" është botuar kohë më parë nga shtëpia botuese "Koha".

KD: Z. Schwartz, si drejtor ekzekutiv i Qendrës për Pluralizëm Islam, i ndiqni për së afërmi zhvillimet brenda islamit. Jeni po ashtu i njohur si një kritik i fuqishëm i fundamentalizmit islam, posaçërisht radikalizmit në formën e sektit vahabi. Cilat janë rreziqet që i shihni ju nga islami politik dhe ekstremizmi?

Schwartz: Kam shkruar shumë kundër vahabizmit. Por momentalisht kam besim në programin e reformave shoqërore të Mbretit Abdullah të Arabisë Saudite dhe, edhe pse është për befasinë e shumë njerëzve që e njohin punën time, unë besoj se ai po përpiket të frenojë klerikët vahabistë edhe brenda, edhe jashtë vendit, ndërkombëtarisht, dhe ta bëjë mbretërinë disi më normale. Në këtë moment jam më shumë i brenqosur me "Vëllazërinë Myslimane". Por, qoftë nëse diskutojmë vahabistët ekstremë, "Vëllazërinë Myslimane", xhihadistët e Azisë Jugore, AKP-në turke të Rexhep Tajip Erdoganit, apo diktaturën homeiniste të klerikëve në Iran – kjo e fundit ndoshta më e keqja momentalisht për shkak të pjesëmarrjes në masakrat në Siri – gjykimi im është gjithnjë i njëjtë.

Islami ka kaluar nëpër tri periudha të radikalizimit të tillë: shpërthimin e Khawarij-it në periudhën fillestare islamike, pushtimin e Spanjës islame nga Al-Muwahiddun apo Almohadët, si uhuhen në Perëndim, gjatë shekujve 12-13, dhe ngritja e vahabizmit dhe imituesve të tij që ka nisur vetëm para 250 vjetëve. Në çdo instancë, radikalizmi i besimtarëve ka dëmtuar zhvillimin shoqëror, politik dhe kulturor mysliman. Radikalët janë armiq të myslimanëve të moderuar, tradicionalë, spiritualë dhe konservativë, dhe të familjeve dhe jetës së tyre. Vahabistët dhe "trashëgimtarët" e tyre nuk janë as të vjetër, as tradicionalë, as konservatorë, sikur që besojnë aq shumë jomyslimanë, e madje edhe disa myslimanë. Ata janë të rinj, ata e shkatërrojnë traditën, dhe ata janë radikalë.

Më duhet të shtoj se unë nuk e përdor termin

Studiuesi Stephen Sylejman Schwartz sheh rrezik nga ekstremizmi islamik në Kosovë, por është i bindur se shqiptarët e Kosovës nuk do të dorëzohen para kësaj sfide. Ai e identifikon kreu e Bashkësisë Islame të Kosovës si problemin kryesor, duke e quajtur madje edhe "Stalin Tërnavava"

"islami politik", sepse besoj që përpjekja jonë për të mbrojtur dinjitetin tonë, besimet tona fetare, dhe praktikatat tona është po ashtu "politike". Por, "islami ynë politik" është një që i mbron besimtarët e moderuar, shtetin dhe kombin nga radikalët.

KD: Ju po ashtu keni njohuri të gjerë për zhvillimet brenda Bashkësisë Islame të Kosovës. Ku e shihni problemin kryesor këtu?

Schwartz: Problemi kryesor është diktatura e Naim Tërnavës në BIK prej vitit 2005. Tërnavava ka inkurajuar hyrjen në Kosovë të radikalëve vahabistë dhe të Vëllazërisë nga Maqedonia. Tërnavava ka refuzuar të veprojë kundër atyre që u përfshinë në sulmet fizike ndaj klerikëve të nderuar dhe shkollarëve me arritje të larta. Tërnavava ka shkarkuar profesorët islamikë, dhe ka larguar klerikët e moderuar e patriotë. Tërnavava efektivisht e ka shqyer Kushtetutën e BIK-it në urinë e tij për një mandat të tretë joligjor. Tërnavava, sikur që është zbuluar nga imami heroik i Be-gracës së Kaçanikut, Adnan Vishi, dëshiron të jetë reis ul-ulema për jetë. Kjo është e papranueshme në islam. Nuk ka asnjë komunitet apo minoritet islamik në botë që e ka një mandat të përjetshëm për një "myfti të madh" – ne e refuzojmë adoptimin e këtij titulli, sepse kreu i klerit në Bosnje-Hercegovinë dhe në Kosovë duhet të quhet ashtu si është quajtur në të kaluarën, "reis ul-ulema". Kush është ky njeri? Enver Hoxhë Tërnavava? Ahmet Zogu Tërnavava? E di që kundër-shtarët e quajnë "Sulltan Tërnavava". Unë e mendoj atë si "Stalin Tërnavava". Ai duhet të hiqet nga çdo përgjegjësi në BIK dhe të gjejë diçka të dobishme për të bërë. Ai duhet të ndjekë shembullin e ish-presidentit amerikan, Jimmy Carter, dhe të bëhet vullnetar në riparimin dhe ndërtimin e shkollave publike dhe shtëpive të reja.

Por, dua të theksoj se nuk e urrej Naim Tërnavën. Nuk jam urrejtës, përveç në raport me agresorët e caktuar sllavë që u sulën kundër kombit shqiptar. E konsideroj Tërnavën, sikur çdo të burgosur të egos së vet (ajo që ne në sufizëm e quajmë nafs), patetik në shpërfilljen që i bën vetërespektit të tij dhe të atyre ndaj të cilëve ka përgjegjësi. Ndiej keqardhje dhe jam i turpëruar për të kur e shoh. Por jam më shumë i brenqosur me atë që ai ka bërë në BIK.

KD: në mesin e librave që keni shkruar, janë edhe libra mbi Kosovën dhe islamit ndër shqiptarë. Në librin tuaj "Islami tjetër" (i botuar në shqip nga Grupi Koha) ju flisni për traditën dhe trashëgiminë e islamit të moderuar, të cilin ju e shihni si përgjigje kundër ekstremizmit islamik. Mendoni se kjo traditë e islamit të moderuar është në sulm në Kosovë dhe në mesin e shqiptarëve?

Schwartz: Islami shqiptar, të cilin, pasi kam udhëtuar dy herë rreth botës, e konsideroj se është shembulli më i mirë i islamit që njoh unë, është i kërcënuar nga ekstremizmi. Situata është e qetë në Shqipëri, konfliktuozë në Kosovë, dhe katastrofale në Maqedoni dhe në Sanxhak në Serbi. Por, unë besoj se masa e besimtarëve myslimanë në tokat shqiptare do t'u rezistojë infiltruesve radikalë. Këta fanatikë nuk e kanë idenë me kë kanë punë. Shqiptarët janë një komb i heronjve. Janë një popull që ka prodhuar Isa Boletinin, Ismail Qemal Vlorën, Bajram Currin, Avni Rrustemin, Shaban Polluzhën, dhe familjen Jashari, dhe, mbi të gjitha, Qerime Shotë Galicën, dhe ata nuk do të dorëzohen para islamit radikal.

Imagjinojeni nëse ai fanatiku Irfan Salihu nga Prizreni do të kishte folur për Shote Galicën ashtu si foli për gratë kosovare që i akuzoi për imoralitet. Imagjinojeni nëse Shefqet Krasniqi do të predikonte kundër Martin Camajit – mik dhe mentor imi personal – ashtu si bëri në lidhje me të bekuarën Nënë Terezën. Imagjinojeni nëse Fuat Ramiqi do të agitonte kundër Albin Kurtit – një tjetër individ të cilin kam nderin ta quaj mik. Albini është politikan dhe njeriu mund të ketë mendim çfarë të dojë për të dhe Lëvizjen Vetëvendosje, por mos e fyeri patriotin.

I vetmi imam që ishte i gatshëm të shërbente xhenazen e familjes Jashari më 1998, Mullah Osman effendi Musliu nga Drenica, është sulmuar brutalisht nga radikalët derisa Tërnavava qëndroi anash. Tërnavava dhe klika e tij e kanë çnderuar Drenicën dhe pavdekësinë e familjes Jashari. Asnjë nga këto ngjarje nuk mund të imagjinohen përveçse në ankh. Dhe kosovarët nuk do të jetojnë në ankh. Ankthi i imperializmit serb ka mjaftuar, dhe nuk ka nevojë të përjetohet imperializmi fetar arab dhe jugaziatik. Kur tmerret e 11 shtatorit 2001 ndodhën në New York, një nga gazetaret në Shqipëri botoi kryetitullin: "Asnjë nuk mund ta mbulojë fytyrën e Statujës së Lirisë". Pra, askush nuk do të kishte guxuar të kërkonte nga Shote Galica të mbante mbulesë apo edhe hixhab dhe askush nuk ka të drejtë të sfidojë patriotizmin e shqiptarëve katolikë. Kam raportuar për masakrën në Korenicë të Gjakovës dhe e di se katolikët ishin po aq viktime të çetnikëve sa edhe myslimanët dhe jobsimtarët. Jo. Kurrë. "S"ka mbulesë për Shote Galicën" duhet të jetë slogani i shkruar gjithandej Kosovës.

KD: Cili është rreziku për Kosovën si shtet i pavarur dhe demokratik, nëse Bashkësia Islame e Kosovës zhytet në ndikimin e ekstremizmit islamik?

Schwartz: Dominimi i Kosovës nga islami radikal do të ishte një katastrofë e pashembullt morale për të gjithë kombin shqiptar, të gjithë Umën globale islamike që ka nevojë për një shembull sikur ky i shqiptarëve dhe posaçërisht i Kosovës, dhe për mbarë botën. As që do të përmend çështjen e ndikimit në SHBA. Vendi im i lindjes mund të përballet me problemet e veta. Unë kam vendosur t'ua kushtoj jetën atyre që kanë nevojë për ndihmën time dhe besoj, shpresoj pa arrogancë apo krenari të tepruar, se kam bërë një kontribut në ndihmën e kombit shqiptar, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbi, dhe në diasporë.